



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7561 prot.

Shkoder, me 06.05. 2019

**Lënda: Dërgim projekt vendimi dhe relacioni**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkoder**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim projekt vendimin dhe relacionin:

**“Për miratimin e planit të trafikut dhe lëvizshmërisë në qytetin Shkodër,”**

*Duke ju uruar punë të mbarw*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR  
  
Voltana ADEMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË TRAFIKUT DHE LËVIZSHMËRISË NË  
QYTETIN SHKODËR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 23 pika 4 dhe 6, nenin 54 shkronja "k", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 8 Dt.: 30.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 dhe programit buxhetor afatmesëm 2018-2019 të bashkisë Shkodër" dhe sipas relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të trafikut dhe lëvizshmërisë në qytetin Shkodër, sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETAR



Drejtorja e shërbimeve publike dhe ndjekjes së investimeve të infrastrukturës

Drejtorja e studimit, planifikimit dhe koordinimit të investimeve

Drejtorja juridike



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË**  
**INFRASTRUKTURËS**

---

Nr. 7561 Prot

Shkodër, më 06.05.2019

**R E L A C I O N**

“Për miratimin e Planit të Trafikut dhe Lëvizshmërisë në Qytetin Shkodër”.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER**

Të nderuar Këshilltarë!

Plani i Trafikut dhe Lëvizshmërisë në Qytetin Shkodër përfaqëson një instrument thelbësor nepërmjet të cilit Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me të gjithë institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, harton sistemin e integruar të qarkullimit dhe të lëvizshmërisë në qytetin Shkodër. Ai është një instrument bazë në përmirësimin e lëvizshmërisë në qytetin e Shkodrës, i cili ndryshon përjasjen e deritanishme që ka patur prioritetin tek përdoruesit e automjeteve.

Ky plan udhëheq zhvillimin e përdorimit të rrugëve dhe hapësirave publike të Bashkisë Shkodër duke patur referim kontekstin e qytetit, zgjidhjen e problematikave aktuale të trafikut, nxitjen e traditës së pedalimit, si dhe duke u bazuar në eksperiencat më të mira të qyteteve europiane, duke pasuruar Planin me koncepte dhe përjasje të reja të domosdoshme për territorin e mbuluar. Ai është dokument kryesor që do të orientojë planifikimin dhe projektimin e përdorimit të rrugëve (përcaktimi i korsive dhe kaheve të bicikletave, hapësirat për këmbësorë, përcaktimi i korsive dhe kaheve të automjeteve, etj). Planifikimi kryhet ne perputhje me kornizen ligjore, te politikave apo strategjive kombetare si dhe ato rajonale e vendore.

Plani i Trafikut dhe Lëvizshmërisë në Qytetin Shkodër ka përcaktuar objektivat për zhvillimin e mobilitetit si dhe investimet prioritare për një periudhë pesë vjeçare 2019-2024. Ai lëviz në dy objektiva kryesore që shërbejnë si masa për përmirësimin e gjendjes aktuale të trafikut në Shkodër:

- rritja e numrit të këmbësorëve, biçikletave dhe përdoruesve të transportit publik,
- demotivimi i përdorimit të automjeteve (qarkullim, qëndrim, parkim, etj) në qendër dhe në zonën urbane të qytetit.

Ky plan shoqërohet me studime të gjendjes aktuale, vizionin për vitet e ardhshme, projekt-ide për akset kryesore dhe për projektet në vijim, të shoqëruara me sinjalistiken përkatëse.

Plani i Trafikut dhe Lëvizshmërisë në Qytetin Shkodër është bazuar në prioritetet dhe nevojat kryesore për një qarkullim sa më të qëndrueshëm:

- Nxitja e ecjes në këmbë, duke rikonceptuar bulevardet kryesore me projekt ide, duke përfshirë rritjen e cilësisë së trotuareve
- Nxitja e traditës së përdorimit të biçikletës, rritja e sigurisë dhe efikasitetit në lëvizjet me biçikletë. Përmirësimi i rrjetit ekzistues, si dhe shtrirja e tij, brenda dhe jashtë zonës urbane (si mjet transporti ose rekreativ)
- Demotivimi i përdorimit të automjeteve në qytet. Duke reduktuar numrin e dhe gjerësinë e korsive, shpejtësinë maksimale, numrin e parkimeve përgjatë rrugës, duke futur konceptin e parkimit me pagesë.
- Ndërhyrjet synojnë shpërndarjen e trafikut përgjatë rrugëve me nënpërdorim, dhe lehtësimin nga trafiku të akseve me trafik të rënduar.
- Është parashikuar sinjalistika vertikale dhe horizontale përkatëse në konformitet me Planin.

Hapat e ndjekur për hartimin e Planit i Trafikut dhe Lëvizshmërisë së Qytetit janë:

1. Prezantimi i fillimit të punës për përgatitjen e Planit;
2. Procesi i konsultimit: Mbledhja e të dhënave;  
Tryeza e parë - diskutime me ekspertë të Bashkisë  
Tryeza e dytë - listimi i nevojave dhe problematikave  
Tryeza e tretë - prioritizimi i nevojave
3. Mbledhja dhe analiza e të dhënave statistikore;
4. Planifikimi strategjik duke përfshirë skenaret e ardhshëm, mekanizmin e implementimit, monitorimit dhe elementet e qëndrueshmërisë;
5. Konsultimi i dokumentit të Planit me ekspertët e Bashkisë;
6. Konsultimi i dokumentit të Planit me Këshillin Bashkiak;

7. Miratimi në Këshill Bashkiak;

8. Botimi i dokumentit.

Ky plan është prioritet dhe mbështetet ne Planin e Përgjithshëm Vendor. Gjithashtu përcakton projektet prioritare në investime për përmirësimin e lëvizshmërisë.

Si i tillë, ky dokument kërkon shqyrtimin dhe miratimin nga ana juaj.

Duke ju falenderuar, ju ftoj të votoni projektvendimin e paraqitur.



*Drejtorja e Shërbimeve Publike, ndjekjes se investimeve të Infrastrukturës*

*Drejtorja Juridike*

*Drejtorja e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit të Investimeve*

*Alban Dajani*